

Titulli i lëndës: FONETIKË

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Letërsisë Shqipe
Titulli i lëndës:	Fonetikë
Niveli:	BA (Baçelor)
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti II Semestri III
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi
Të dhënat kontaktuese:	shpetim.elezi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Fonetika është degë e gjuhësisë që studion mjetet tingullore të gjuhës, shikuar nga aspekti i nyjëtimit të tyre, ndërsa fonologjia studion anën funksionale të tyre. Lënda, së këndejmi, i ofron përshkrimin dhe klasifikimin e tingujve të shqipes, mekanikën e nyjëtimit të tyre, togjet, transkriptimin, por edhe funksionin e tyre në ligjërim. Kursi përfshin edhe ndryshimet e gjalla dhe historike të tingujve, si dhe njësi si theksi, rrokja dhe intonacioni.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs synon t'ua ofrojë studentëve njohuritë gjithëpërfshirëse të sistemit të bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve të shqipes, karakteristikat dalluese të tyre, togjet e tingujve si dhe klasifikimin e përgjithshëm të tingujve. Po ashtu, synon edhe përgatitjen e studentëve për elementet mbisegmentare. Ky kurs njëherësh synon t'i përgatisë studentët për t'i dalluar fonemat nga variantet, për t'i vërejtur kundërvëniet tingullore brenda shqipes, por edhe për t'i dalluar dhe për t'i analizuar ndryshimet fonologjike brenda shqipes si në rrafshin diakronik, ashtu edhe në atë sinkronik.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti: <ul style="list-style-type: none">nyjëton tingujt e shqipes;përshkruan sistemin e aparatit të të folurit;përshkruan sistemin tingullor të shqipes;klasifikon zanoret dhe bashkëtingëlloret;dallon fonemën nga variantet e fonemës;analizon sistemin e kundërvënieve fonologjike brenda shqipes;dallon alternimet e gjalla dhe historike të shqipes;analizon veçori të theksit, rrokjes e intonacionit;transkripton tingujt e të folurit në një variacion të gjerë.
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)	

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.25
Ushtrime	1	15	11.10
Përgatitje për test intermediar	3	4	12
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	4	8
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	10 min	15	2.5
Totali			111.35 orë 111.35:25=4.45 4 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.</p> <p>Mësimdhënia gjatë ligjëratave do të jetë e organizuar nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara. Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme dhe të paqarta.</p> <p>Studentët kanë punime seminari e punime të tjera me shkrim të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë në çifte e në grupe. Përmes projekteve e prezantimeve nxiten debate e diskutime midis tyre.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 51%.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive e studentit 10%; • Detyrat në klasë dhe prezantimi 10%; • Detyrat e shtëpisë dhe seminari 20%; • Kolokuiumi I 30%; • Kolokuiumi II 30%; <p>Gjithsej 100%.</p> <p>Notat: 51 – 60 % (6), 61 – 70 (7), 71 – 80 (8), 81 – 90 (9), 91 – 100 (10).</p>		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dodi, Anastas (2004). Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe. Tiranë. 2. Rugova, Bardh (2019). Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë. Prishtinë: ASHAK. 3. Beci, Bahri (2004). Fonetika. Prishtinë. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Badallaj, Imri (1999). Nazalizimi i zanoreve të shqipes. “Dardania Sacra”, nr. 1. Prishtinë. 2. Boriqi, Lumnie (1987). Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe. “Studime filologjike”, nr 2. Tiranë. 3. Boriqi, Lumnie (1991). Rreth fonemës në shqipen e sotme letrare. “Studime filologjike”, nr 2. Tiranë. 4. Hamp, Eric P. (2007). Studime krahasuese për shqipen. Prishtinë. 5. Ismajli, Rexhep (1973). Ndërlidhni kundërvëniesh në sistemin bashkëtingëllor të shqipes. “Përparimi”, nr 1. Prishtinë. 6. Ismajli, Rexhep (1987). Artikuj për gjuhën shqipe. Prishtinë: Rilindja. 7. Martine, Andre (1983). Elemente të gjuhësisë së përgjithshme. Prishtinë: Rilindja. 8. Sawicka, Irena – Dargiel, Karolina (2018). Struktura e rrokjes shqipe. Prishtinë: ASHAK. 9. Ssaussure, F. (1977). Kurs i gjuhësisë së përgjithshme. Prishtinë. 10. Topalli, Kolec (1995). Theksi në gjuhën shqipe. Tiranë. 		

11. Topalli, Kolec (1998). Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes. Tiranë.
12. Topalli, Kolec (2001). Sonantet e gjuhës shqipe. Tiranë.
13. Topalli, Kolec (2002). Mbylltoret e gjuhës shqipe. Tiranë.
14. Topalli, Kolec (2003). Fërkimoret dhe afrikatat e gjuhës shqipe. Tiranë.
15. Topalli, Kolec (2004). Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH.
16. Topalli, Kolec (2006). Fonetika historike e shqipes. Tiranë.
17. Trubeckoi, N. S. (1985). Parime të fonologjisë. Prishtinë: Rilindja.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Historia e gjuhës dhe e shkrimit
Java 2:	Fonetika – objekti i fonetikës dhe lidhja e saj me disiplinat e tjera
Java 3:	Tingujt dhe aspektet e studimit të tyre
Java 4:	Organet e aparatit të të folurit dhe truri
Java 5:	Klasifikimi dhe përshkrimi i tingujve të gjuhës shqipe
Java 6:	Klasifikimi dhe përshkrimi i zanoreve të shqipes
Java 7:	Klasifikimi dhe përshkrimi i bashkëtingëlloreve të shqipes (KOLOKUIUMI 1)
Java 8:	Elementet mbisegmentare: Theksi
Java 9:	Rrokja dhe intonacioni
Java 10:	Fonema dhe varianti
Java 11:	Kundërvëniet fonologjike; Tufat e korrelacioneve
Java 12:	Alternimet historike të zanoreve të shqipes
Java 13:	Alternimet historike të bashkëtingëlloreve
Java 14:	Alternimet e gjalla (kombinatorike) (KOLOKUIUMI 2)
Java 15:	Transkriptimi fonetik; Programet kompjuterike për matjet fonetike (PREZANTIMET)

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.